

Protesta

Të Gjelberit dhe LSI i bashkëngjiten Protestës së Banorëve të Kombinatit për Sharrën Maj 2007.



Banorët e Sharrës kanë bllokuan rrugën që të çon në zonën ku hidhen mbeturinat. Protesta ka vazhduar edhe gjatë ditës së djeshme. Me pankarta që shkruanin “**STOP NDOTJES NË SHARRE**“, ata i kanë bërë apel qeverisë të marrë menjëherë masat për të përmirësuar situatën e krijuar.

“Nuk do të pranojmë më që ne dhe të afërmit tanë të vdesim për shkak të ndotjes që është këtu“, u shprehen banorët.





SHARRË ; Djegia dhe shkarkimi i mbeturinave në këtë zone

Tym që dukej që larg dhe mbeturina pafund. Ndonëse rruga që të çon në “**bombën ekologjike**“ ka qenë e bllokuar nga protestat e banorëve , menjëherë pas lirimimit të saj kanë mbërritur kamionët e parë me plehra. Askush nuk i ka penguar të bëjnë punën e tyre të përditshme. Të heqin qafe plehra e inerte të mbledhura kushedi se ku. Madje të qetë dhe pa i penguar askush,.

Kërkesa kryesore e tyre është të pengohet hedhja e mbeturinave në këtë zonë. “Duam gjithashtu të shuhet djegia e plehrave dhe të merren masa për t’i mbuluar ato“, thanë banorët.

Deri tani për zonën e Sharrës, e cila që prej vitesh është kthyer në burim sëmundjesh e infeksionesh për banorët që jetojnë aty, nuk është ofruar asnjë zgjidhje.

Më në fund durimi i tyre ka sosur dhe kanë dalë në protesta për të penguar ndotjen, por edhe në këtë rast nuk u është dhënë asnjë përgjigje. Ato kanë zgjatur për disa orë, ndërsa kamionët kanë vazhduar të zbrazen menjëherë pas përfundimit të saj. Madje banorët e zonës sqarojnë se pjesa më e madhe shkarkohen edhe gjatë natës.

“Kërkesat plotësisht të ligjshme të banorëve të Sharrës kanë rënë në vesh të shurdhër dhe s’kanë gjetur asnjë zgjidhje“,.. “Ata i bëjmë thirrje qeverisë edhe njëherë të marrë masa për të ndërhyrë në këtë **bombë ekologjike që kërcënon jetën e qytetarëve**“

Banorët e zonës kanë kërkuar që fusha të mos shërbejë më për djegien e mbeturinave të qytetit, pasi ndotja prej tyre është bërë shkaktare e shumë vdekjeve.